

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – SHËRBIME**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim i auditim dhe certifikim sipas standardit ISO 27001:2022 nga një trupë certifikuese”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
79130000-4**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5,000,000 (pesë milion) Lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor IdentiTek Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Shtojca 8**

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

1. Operatori Ekonomik duhet të jetë një organizëm i vlerësimit të konformitetit për sistemet e menaxhimit dhe duhet të jetë aktualisht i akredituar për lëshimin e certifikatës ISO 27001 nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

**Argumentim:** ISO/IEC 27001 është një standard sigurie që specifikon zyrtarisht një Sistem të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS) që synon të sjellë sigurinë e informacionit nën kontrollin e qartë të menaxhimit. Si një specifikim formal, ai mandaton kërkesat që përcaktojnë se



identiTek

si të zbatohet, monitorohet, mirëmbahet dhe përmirësohet vazhdimisht ISMS. Ai gjithashtu përshkruan një sërë praktikash më të mira që përfshijnë kërkesat e dokumentacionit, ndarjet e përgjegjësisë, disponueshmërinë, kontrollin e aksesit, sigurinë, auditimin dhe masat korrigjuese dhe parandaluese. Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto Certifikata duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomikë ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e projektit dhe në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
  - b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon stafit të kualifikuar për realizimin e këtij shërbimi si më poshtë:
- a. Minimumi **1 (një) Ekspert/ Drejtues Ekipi** i cili të jetë i certifikuar si ISO 27001 Lead Auditor ose ekuivalente me të, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (në gjuhën shqipe ose të përkthyer/noterizuar);

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomën përkatëse;
- Kontratën e punës e vleshme;
- CV përkatëse;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore;

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky certifikim ndihmon AK të verifikojë aftësitë profesionale të OE për zbatimin e kësaj kontrate, e cila ka të bëjë konkretisht me ndërtimin e dokumentacionit të nevojshëm për tu certifikuar me standartin ISO27001. Me anë të këtij certifikimi verifikohet aftësia për të planizuar dhe implementuar praktikën më të mira të standartit të kërkuar. Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të vërtetojë që punonjësi me certifikimin në sigurinë e informacionit, pjesë e stafit teknik të operatorit ekonomik, ka aftësi të planifikojë, të udhëheqë, të raportojë dhe të auditojë menaxhimin e sigurisë së informacionit në funksion të platformës që do të zhvillohet dhe mirëmbahet, si dhe të garantojë që sistemi është konform standardeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, në të gjithë hallkat funksionale të tij, duke mundur kështu menaxhimin në mënyrë të sigurt të informacionit. Prania e tij jep garanci për sigurinë e informacionit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 20.05.2024; Ora: 10:00; Vendi: “IdentiTek” Sh.a, Rruga “Xhanfize Keko”, Ish Topografia Ushtarake, Tiranë.**